


Bibël për fëmijët paraqet

Jezusi Zgjedh Dymbëdhjetë Ndihmës



Shkruar nga: Edward Hughes
Ilustruar nga: Byron Unger; Lazarus

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi
Adaptuar nga: E. Frischbutter; Sarah S.

Tregimi 39 nga 60

www.M1914.org


Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.

Shqip

Albanian

Jezusi bëri gjëra të mrekullueshme. Ai shëroi sëmundjet, u dha njerëzve të turbulluar paqe në mendjet e zemrat e tyre, dhe u mësonte Fjalën e Perëndisë.



1

Turmat erdhën tek Jezusi për ndihmë dhe shërim.



2

Ai vendosi të zgjidhte dymbëdhjetë njerëz nga ndjekësit e Tij të shumtë, ta ndihmonin Atë në punën e Tij për Perëndinë.



3

Nëse keni zgjedhje të rëndësishme për të bërë, a i luteni ju Perëndisë? Jezusi lutej! Në një vend të qetë në mal, Ai foli me Atin e Tij Qiellor.



4

Gjatë gjithë natës së gjatë e të errët, Jezusi u lut.



5

Në mëngjes, Ai thiri ndjekësit e Tij - të gjithë miqtë që i shërbenin dhe i bindeshin.



6

Dy të parët që Jezusi zgjodhi ishin vëllezër, Simon Pjetri dhe Andrea. Ata e kishin lënë punën e tyre si peshkatarë, qysh në fillim kur Jezusi i thirri ta ndjekin, Atë.



7

Jakobi dhe Gjoni, djemtë e Zebedeut, kishin lënë rrjetat e tyre të peshkimit.



8

Jezusi gjithashtu zgjodhi Filipin, Bartolomeun, Mateun, Thomain, Simonin Zelotin, Jakobin birin e Alfeut, Judën vëllain e Jakobit, dhe Judë Iskariotin i cili më vonë u bë armik i Jezusit.




9

Jezusi u mësoi atyre, që duke bërë çfarë Ai thotë është sikur të ndërtosh një shtëpi në themel të qëndrueshëm. Stuhitë e tërbuara nuk do ta shkatërrojnë atë shtëpi.



10

Por të mos i bindesh Fjalës së Jezusit është sikur të ndërtosh një shtëpi në themel prej rëre. Kur stuhia fryn, shtëpia do të bjerë.



11

Disa nga urdhërat e Jezusit nuk ishin të lehta. "Nëse një njeri të godet në faqen e djathtë, ofroi edhe të majtën", i mësonte Ai. "Duajini armiq të tuaj". Njerëzit kanë nevojë për ndihmën e Perëndisë për të jetuar si Jezusi.



12

Jezusi gjithashtu u tregoi njerëzve të lutën në sekret - të mos luten sa për sy e faqe përpara njerëzve, si disa drejtues fetarë bëjnë.



13

Jezusi tha se Perëndia do të ushqejë dhe veshë, njerëzit që i besojnë Atij.



14

Meqënëse Perëndia u jep ushqim zogjve dhe ngjyra të bukura luleve dhe shkurreve, njerëzit e Tij mund ti besojnë Atij për nevojat e tyre.




15

Jezusi, u mësoi shumë gjëra ndihmësve të Tij të sapozgjedhur. Kur Ai mbaroi, një lebroz erdhi, duke i lutur Jezusit për shërim.




16

Jezusi iu përgjigj lebrozit, "Unë dua. Shërohu". Ndërsa ndihmësit vështronin, lebrozi u shërua. Ai u shërua plotësisht!



17

Vetëm Biri i Perëndisë mund ta bënte këtë. Ndihmësit e dinin që ata kishin një Mësues të mrekullueshëm.



18

Jezusi Zgjedh Dymbëdhjetë Ndhmës
Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla
e marrë nga

Mateut 4-7, Markut 1, Llukës 6

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."
Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mekatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shume sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë: Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmon. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!

